



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM

Nr. 48, datë 6.9.2017

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR RAPORTIMET NË BANKËN E SHQIPËRISË TË STATISTIKAVE TË NORMAVE TË
INTERESIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Statistikave Financiare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për raportimet në Bankën e Shqipërisë të statistikave të normave të interesit”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet i Departamenti i Statistikave Financiare me zbatimin e këtij vendimi.
3. Bankat, deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi, marrin masat dhe krijojnë kushtet e nevojshme për zbatimin e kërkesave të rregullores, si dhe për raportimin e të dhënave sipas formës, përmbajtjes dhe afateve të përcaktuara.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe në Buletinin Zyrtar Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

Elvis Çibuku

Gent Sejko

KREU I

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave mbi procedurat dhe afatet e raportimit të statistikave të normave të interesit pranë Bankës së Shqipërisë nga subjektet e kësaj rregulloreje.

Neni 2

Qëllimi

Informacioni i siguruar nga formularët e raportimit është i nevojshëm për hartimin e statistikave të normës së interesit, të cilat përdoren për qëllime të zbatimit të politikës monetare dhe parashikimeve makroekonomike në Bankën e Shqipërisë, si dhe për të informuar institucionet e tjera dhe publikun e gjerë mbi zhvillimet në normat e interesit nga subjektet e kësaj rregulloreje.

Neni 3

Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë (për thjeshtësi, këtu e më poshtë në rregullore, do të quhen “banka”).

Neni 4

Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe në përputhje me nenin 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar ;

Neni 5

Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.
2. Përveç sa parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni, vetëm për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë këtë kuptim:
 1. Norma vjetore e pranuar (AAR) – një normë interesi e dakordësuar në marrëveshjen ndërmjet bankës dhe një klienti (individ apo korporatë jo-financiare) e llogaritur mbi një bazë vjetore dhe e kuotuar në përqindje. Norma e interesit nuk do të përfshijë komisionet, shpenzimet administrative dhe shpenzime të tjera për kredinë dhe depozitat.
 2. Norma efektive e interesit (NEI) – ka të njëjtin kuptim me përkufizimin sipas shkronjës “a” të pikës 2 të nenit 4 të rregullores së Bankës së Shqipërisë “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”, miratuar me vendimin nr.59, datë 29.08.2008 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar.
 3. Norma efektive e interesit sipas përkufizimit të ngushtë (NDER) – është një normë vjetore interesi, e cila barazon vlerën aktuale të të gjitha angazhimeve të ardhme ose ekzistuese (depozita ose kredi, pagesat ose

- ripagime, pagesa interesi), të ndryshme nga komisione/shpenzime që rezultojnë nga termat dhe kushtet e marrëveshjes midis subjektit raportues dhe klientit (individ apo korporatë jofinanciare).
4. Periudha fillestare e fiksimit të normës së interesit – është periudha fillestare për të cilën është rënë dakord me nënshkrimin e kontratës, gjatë së cilës vlera e normës së interesit nuk do të ndryshojë. Periudha fillestare mund të jetë më e vogël ose e barabartë me maturitetin fillestar të një huaje.
 5. Linjat e kredive (kreditë qarkulluese) – janë ato kredi të cilat kanë këto karakteristika:
 - a. kredimarrësi mund të tërheqë fonde në sasi të rëna dakord, pa njoftuar më parë huadhënësin;
 - b. shuma e kredisë në dispozicion mund të luhetet si pasojë e tërheqjeve dhe shlyerjeve të huasë;
 - c. kredia mund të përdoret në mënyrë të përsëritur;
 - d. nuk ka asnjë detyrim për të shlyer kredinë në baza të rregullta.
 6. Overdraft – është kontrata e kredisë sipas së cilës banka i jep kredimarrësit mundësinë e disponimit të fondeve në llogarinë e tij rrjedhëse, që tejkalojnë gjendjen aktuale të fondeve në këtë llogari ose premtion t'i japë kredi mbajtësit të kartës së kreditit, deri në një kufi të paracaktuar në kontratë;
 7. Kredi për blerje banesash – është kredia dhënë individëve me qëllim blerje banese, apartamenti ose toke, për ndërtim (shtëpi/apartament), përfshirë huatë hipotekare dhe huatë për rikonstruksion, të cilat shtojnë vlerën ekonomike të banesës (shtëpisë, apartamentit).
 8. Kredi dy-nivelëshe përmes kartave të pagesës – është kredia që jepet nga banka për individë dhe korporata jofinanciare, përmes kartave të debitit të shtyra dhe kartave të kreditit në dy nivele pagese si kredi lehtësuese dhe kredi të zgjeruar.
 9. Kredi lehtësuese e kartës së kreditit – është kredia që jepet nga banka për individë dhe korporata jofinanciare, si mbajtës të një karte krediti, me interes 0%, në periudhën nga data e përdorimit të saj deri në datën së faturimit.
 10. Kredi e zgjeruar e kartave të kreditit – është shuma e mbetur në llogari (e papaguar), pas datës së faturimit përkatës, mbi të cilën zakonisht paguhet interes më i lartë se zero për qind, për të cilën konsumatori duhet të paguajë këste mujore minimale për të shlyer të paktën pjesërisht borxhin e zgjeruar të kartës së kreditit.
 11. Kredi konsumatore – ka të njëjtin kuptim të përcaktuar në nenin 44 të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar;
 12. Kredi të tjera – është kredia dhënë individëve për qëllime të tjera të ndryshme nga blerja e banesave ose kredia për konsum, për shembull kredia për ushtrim biznesi, studime.
 13. Kredi të rinegociuara – janë ato kredi, kontratat e të cilave janë rinegociuar (rishikuar), duke përfshirë aktivisht kredimarrësin në ndryshimin e termave dhe kushteve të një kontrate ekzistuese, përfshirë normën e interesit.
 14. Depozita një ditore – janë depozita lehtësisht të konvertueshme në parë dhe/ose drejtpërsëdrejti të transferueshme, sipas kërkesës nëpërmjet mjeteve të pagesave të përdorura gjerësisht, të tilla si: çeket, debitimi ose

kreditimi i drejtpërdrejtë, apo mjeteve të tjera të pagesës, pa vonesa, kufizime dhe gjoba. Këto depozita gjithashtu përfshijnë:

- a. teprica (kreditore) në llogari (me ose pa interes), të cilat janë lehtësisht të konvertueshme në para, sipas kërkesës në fund të ditës së punës kur është bërë kërkesa pa kufizime dhe gjoba, por që nuk janë të transferueshme;
 - b. teprica (kreditore) në llogari (me ose pa interes) që përfaqësojnë parapagime (për shembull karta të parapaguara);
 - c. kreditë për t'u paguar një ditë pas ditës që është akorduar kredia.
15. Depozita me njoftim paraprak – janë depozita jo të transferueshme dhe me afat maturimi të papërcaktuar, të cilat mund të tërhiqen vetëm pas një periudhe paraprake njoftimi.
 16. Repo – ka të njëjtin kuptim me termin “Kontrata e riblerjes së titujve” të përcaktuar në nenin 3, pika 1 të ligjit nr. 9974, datë 28.07.2008, “Për kontratën e riblerjes së titujve”,.
 17. Maturiteti fillestar (origjinal) – është periudha e fiksuar e kohëzgjatjes së një kontrate (depozite/kredi), përpara së cilës nuk lejohet tërheqja/shlyerja, ose shoqërohet me penalitet.
 18. Maturiteti i rënë dakord (me afat të caktuar) – periudha e kohës që nga data e fillimit të transaksionit deri në datën e fundit të dakordësuar. Maturiteti i pranuar është karakteristikë për depozitat.
 19. Maturiteti i mbetur – periudha e kohës që nga data e fundit e raportimit deri në datën e fundit të rënë dakord në marrëveshje.
 20. Gjendja në fund të periudhës – nënkupton stokun e të gjithë depozitave të vendosura dhe të patërhequra nga klientët e bankave dhe stoku i të gjitha huave të dhëna nga bankat, por të papaguara nga klientët e tyre në ditën e fundit të periudhës së raportimit.
 21. Kredi me probleme – ka të njëjtin kuptim me përkufizimin sipas, nenit 4, pika 2, shkronja “g” të rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja ”, miratuar me vendimin nr.62, datë 14.09.2011 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, i ndryshuar.
 22. Kolateral - ka të njëjtin kuptim me përkufizimin sipas nenit 4, pika 2, shkronjës “j”, të rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, miratuar me vendimin nr.62, datë 14.09.2011 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, i ndryshuar.
 23. Garanci - ka të njëjtin kuptim me përkufizimin sipas nenit 4, pika 2, shkronja “k”, të rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja ”, miratuar me vendimin nr.62, datë 14.09.2011, i ndryshuar.
 24. Individë - nënkupton sektorin e individëve (ekonomitë familjare) dhe sektorin e institucioneve (institucionet jo me qëllim fitimi në shërbim të individëve) që u shërbejnë individëve:
 - a. individët (Ekonomitë familjare) – përbëhet nga individë dhe grupe individësh, të cilët janë kryesisht konsumatorë, ndajnë të njëjtën banesë dhe të ardhura të përbashkëta dhe konsumojnë kolektivisht mallrat dhe shërbimet. Përfshihen, gjithashtu, individë ose grupe individësh, të cilët janë të angazhuar në aktivitet ekonomik, për shitje në treg ose për konsumin e vetë ekonomisë familjare. Në këtë sektor përfshihen personat fizikë (tregtarët), të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në

përputhje me nenin 2 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

- b. institucionet jo me qëllim fitimi në shërbim të individëve – përbëhet nga institucionet jo me qëllim fitimi, të cilat janë njësi ligjore të pavarura, u shërbejnë ekonomive familjare dhe nuk prodhojnë për tregun. Institucione të tilla i sigurojnë ekonomive familjare mallra dhe shërbime falas, ose me çmime që nuk janë ekonomikisht domethënëse.
25. Korporata jofinanciare – janë persona juridikë të angazhuara në aktivitete dhe transaksione ekonomike. Këtu përfshihen të gjitha shoqëritë tregtare të cilat nuk ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare, si dhe e ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
26. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) – ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në nenin 5, të ligjin nr.10 042, datë 22.12.2008 "Mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme".
27. Rezident – ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në nenin 4, pika 3 të rregullores "Për veprimtarinë valutore" miratuar me vendimin nr. 70, datë 30.09.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
28. Periudha referencë – është periudha, në këtë rast muaji, për të cilën bankat raportojnë pranë Bankës së Shqipërisë.

KREU II

Kërkesat raportuese

Neni 6

Forma, përmbajtja dhe afatet e raportimit

1. Bankat duhet të hartojnë dhe dërgojnë pranë Bankës së Shqipërisë, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike pas përfundimit të periudhës referencë, formularët e raportimit si më poshtë (Aneksi 1 i rregullores):
 - 1.1. Normat e interesit mbi sasinë gjendje në fund të periudhës të emëruar në lekë (FA_ALL)
 - 1.2. Normat e interesit mbi sasinë gjendje në fund të periudhës të emëruar në euro (FA_EUR)
 - 1.3. Normat e interesit mbi sasinë gjendje në fund të periudhës të emëruar në usd (FA_USD)
 - 1.4. Normat e interesit mbi sasinë e re (fluksi i ri) të emëruar në lekë (FB_ALL)
 - 1.5. Normat e interesit mbi sasinë e re (fluksi i ri) të emëruar në euro (FB_EUR)
 - 1.6. Normat e interesit mbi sasinë e re (fluksi i ri) të emëruar në usd (FB_USD)
 - 1.7. Kreditë e rinegociuara (RNG)
 - 1.8. Normat e interesit mbi sasinë gjendje - Sipas maturitetit të mbetur (ORM)
 - 1.9. Kredihënia për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme - Shpërndarja sektoriale (Tremujore).
2. Raportimi i formularëve të normave të interesit nga bankat kryhet në periudha 1 (një) mujore, me përjashtim të formularit "Kredihënia për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme - Shpërndarja sektoriale", i cili raportohet në periudha tremujore.
3. Bankat raportojnë elektronikisht në Sistemin Elektronik Raportues Rregullator (ERRS).
4. Normat e interesit raportohen në përqindje, me katër shifra pas presjes dhjetore.
5. Kërkesat e raportimit janë të kufizuara në korporatat jofinanciare dhe individët rezidentë në territorin e Shqipërisë.

- Raporti i normave të interesit bëhet veçmas për depozita dhe kredi të emëruara në monedhë kombëtare (Lek), Euro dhe dollarë amerikanë.

KREU III Metoda e përlogaritjes

Neni 7

Metoda e llogaritjes së normës së interesit

- Bankat, për qëllime të kësaj rregulloreje, llogarisin normën vjetore të pranuar të interesit dhe normën efektive të interesit sipas përkufizimit të ngushtë për depozitat dhe kreditë bazuar në termat dhe kushtet e çdo marrëveshjeje me klientin.
- Bankat llogarisin normën vjetore të interesit të pranuar (AAR), në rastet kur:
 - kapitalizimi i interesit kryhet në intervale të rregullta dhe përkon me skedulën e shlyerjeve të kryegjësë (principalit).
 - shlyerja e principalit dhe kapitalizimi i interesit kryhet në intervale të rregullta dhe pagesat e interesit janë më të shpeshta se shlyerja e principalit.
- Bankat llogarisin normën efektive të interesit sipas përkufizimit të ngushtë (NDER), vetëm në rastet kur:
 - shlyerja e principalit të kredisë kryhet në intervale të rregullta, ndërsa pagesat e interesit kryhen në intervale jo të rregullta ose janë më pak të shpeshta sesa shlyerjet e principalit.
 - pagesat e interesit kryhen një herë në çdo tremujor, ndërkohë që shlyerjet e principalit kryhen në intervale jo të rregullta.
- Norma vjetore e pranuar e interesit llogaritet me formulën:

$$AAR = \left(1 + \frac{r}{n} \right)^n - 1$$

Ku:

AAR është norma vjetore e pranuar e interesit;

r është norma e interesit në vit e përcaktuar në marrëveshjen midis subjektit raportues dhe klientit (në rastet kur marrëveshja përcakton norma të ndryshueshme të interesit, si r aplikohet norma e interesit e llogaritur në momentin e dhënies së kredisë ose pranimit të depozitës);

n është numri i periudhave të kapitalizimit të interesit në një vit (p.sh. “1” për pagesat vjetore, “2” për pagesat gjashtëmujore, “4” për pagesat tremujore dhe “12” për pagesat mujore).

- Norma efektive e interesit sipas përkufizimit të ngushtë llogaritet me formulën:

$$A = \sum_{n=1}^N (CF_n \cdot DF_n) = \sum_{n=1}^N \left(CF_n \cdot \left(\frac{1}{1+i} \right)^{\frac{D_n}{365}} \right)$$

Ku:

A është sasia/vëllimi i kredisë/depozitës së dhënë/pranuar;

N është numri total i shlyerjeve;

CF_n është pagesa e n-të;

- DF_n është faktori i skontos së pagesës së n -të;
- i është norma efektive e interesit sipas përkufizimit të ngushtë (ose norma vjetore në përqindje e kostos (APRC));
- D_n numri i ditëve nga data kur është dhënë kredia (pranuar depozita) në datën e pagesës së ardhshme n .

Neni 8

Procedura për hartimin dhe raportimin e normave të interesit mbi sasinë e re

1. Formularët e raportimit të normave të interesit për sasinë e reja duhet të përfshijnë të gjitha marrëveshjet e reja të kryera nga bankat në periudhën referencë.
2. Marrëveshjet e reja janë:
 - 2.1. të gjitha kontratat financiare afatet dhe kushtet e të cilave përcaktojnë për herë të parë normën e interesit, shumën e depozitave dhe kredive; dhe
 - 2.2. depozitat dhe kreditë e rinegociuara.
3. Nuk do të konsiderohet sasi e re (fluksi i ri):
 - 3.1. zgjatja automatike (pa përfshirjen aktive të klientit) të kontratave ekzistuese të kredive dhe depozitave, e cila nuk përfshin asnjë rinegociim të termave dhe kushteve të kontratës, përfshirë këtu normat e interesit.
 - 3.2. zëvendësimi i normës fikse të interesit me një normë të ndryshueshme interesi dhe anasjelltas gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes (në një moment kohor t_1), për të cilën palët kanë rënë dakord që në fillimin e saj (në momentin kohor t_0).
4. Marrëveshjet e reja që përfshijnë kreditë, overdrafte-t, linjat e kredive (kreditë qarkulluese), kredia e zgjeruar e kartave të kreditit, depozitat e pranuar dhe transaksionet repo raportohen në formularët “Normat e interesit mbi sasinë e re (fluksi i ri)”, sipas emërimit të instrumenteve. Transaksionet, të cilat e kanë datën e shlyerjes në periudhën e ardhshme të raportimit konsiderohen, gjithashtu, si transaksione të reja për periudhën referencë.
5. Overdraft-et, linjat e kredive (kreditë qarkulluese), kredia e zgjeruar e kartave të kreditit duhet të raportohen në formularët “Normat e interesit mbi sasinë e re (fluksi i ri) si gjendja (balanca) në ditën e fundit të muajit raportues (periudhës referencë).
6. Në rastin kur kredia jepet si linjë kredie (kredi qarkulluese), në formularin “Normat e interesit mbi sasinë e re (fluksi i ri)” raportohet shuma e tërhequr dhe e pashlyer (jo e ripaguar) në fund të periudhës së raportimit. Shuma e disponueshme si linjë kredie, e patërhequr ose e shlyer, nuk do të raportohet as si sasi e re e as si gjendje (stok) në fund të periudhës.
7. Kur një individ apo korporatë jofinanciare realizon tërheqje të kredisë në transhe, në momentet t_1 , t_2 , t_3 , etj., dhe jo tërheqje të të gjithë shumës në një herë të vetme në fillimin e marrëveshjes (në momentin t_0), raportimi në formularët “Normat e interesit mbi sasinë e re (fluksi i ri)” do të bëhet për momentin t_0 , duke përfshirë normën e interesit dhe shumën e plotë të huasë sipas marrëveshjes.
8. Kreditë e dhëna për të vetëpunësuarit për veprimtari tregtare do të raportohen të dalluara në treguesin “kredi për qëllime të tjera për individët”. Nëse kreditë u jepen të vetëpunësuarve për konsum privat, këto kredi do të raportohen brenda treguesit “Kredi të individëve për blerje banesash” ose “Kredi konsumatore për individët”.
9. Raportimi i çdo kredie të re (fluksi i ri) dhënë korporatave jofinanciare duhet të detajohet sipas madhësisë së tyre, respektivisht në tre kategoritë e mëposhtme:

- 9.1. Për raportimet në Euro: (a) deri në 0,25 milionë euro, (b) mbi 0,25 deri 1 milionë euro dhe (c) mbi 1 milionë euro.
- 9.2. Për raportimet në USD: (a) deri në 0,25 milionë usd,(b) mbi 0,25 deri 1 milionë usd dhe (c) mbi 1 milionë usd.
- 9.3. Për raportimet në Lekë: (a) deri në 35 milionë lekë, (b) mbi 35 deri 140 milionë lekë dhe (c) mbi 140 milionë lekë.
10. Kreditë për korporatat jofinanciare, me normë interesi të ndryshueshme, periudhë fillestare të fiksimit të normës së interesit deri në një vit dhe afat fillestar maturimi mbi një vit do të raportohen veçmas në formularët “Normat e interesit mbi sasinë e re (fluksi i ri)”.
11. Në formularët “Normat e interesit mbi sasinë mbi sasinë e re (fluksi i ri)” do të paraqiten të dalluara kreditë e kolateralizuara/garantuara, në rastin kur vlera e kolateralit/ garancisë është e barabartë ose më të lartë se vlera e kredisë.
12. Në formularët “Normat e interesit mbi sasinë e re (fluksi i ri)” kreditë (me përjashtim të overdrafte-ve, kredive qarkulluese dhe borxhi i zgjeruar i kartave të kreditit), do të klasifikohen sipas periudhës fillestare të fiksimit të normës së interesit. Kreditë, për të cilat nuk ka periudhë fillestare të fiksimit të normës së interesit, do të raportohen në nën-treguesin “normë e ndryshueshme dhe deri në një vit normë fillestare e pandryshuar” për individët dhe në “normë e ndryshueshme dhe deri në 3 muaj normë fillestare e pandryshuar” për korporatat jofinanciare.
13. Kreditë e rinegociuara do të raportohen në përputhje me rregullat e paraqitura në paragrafët 2, 9, 10 dhe 11 të këtij neni, si kredi për individët dhe kredi për korporatat jofinanciare, të klasifikuar sipas tipit të instrumentit.
14. Depozitat do të raportohen duke mbajtur në vëmendje afatin e maturimit për të cilin është dakordësuar në marrëveshje.
15. Norma mesatare e ponderuar e interesit për qëllime të raportimit të formularëve “Normat e interesit mbi sasinë e re (fluksi i ri)” do të llogaritet duke zbatuar formulën e mëposhtme:

$$R = \left(\frac{A_1 \times V_1 + A_2 \times V_2 + \dots + A_n \times V_n}{\sum_{k=1}^n V} \right)$$

Ku:

R – norma mesatare e ponderuar e interesit;

V_n – shuma/vëllimi i secilës kredi të re;

A_n – norma vjetore e pranuar e secilës kredi të re, norma efektive e interesit sipas përkufizimit të ngushtë ose norma efektive e interesit.

16. Për kredi dhënë individëve për blerje banese dhe kredi konsumatore duhet të llogaritet edhe norma efektive e interesit (NEI), sipas formulës së mëposhtme:

$$\sum_{K=1}^m \frac{S_K}{(1+i)^{t_K}} = \sum_{K'=1}^{m'} \frac{S'_{K'}}{(1+i)^{t_{K'}}$$

Ku:

K – numri rendor i tërheqjes së një huaje;

– numri rendor i ripagesës/shlyerjes së një kredie;

- S_K – sasia/shuma e K-të e huasë së tërhequr;
- S'_K – sasia/shuma e K'-të e ripagesës/shlyerjes së kredisë (principali, interesi, komisione dhe pagesa të tjera);
- m – numri rendor i tërheqjes së fundit të kredisë;
- m' – numri rendor i ripagesës së fundit të kredisë;
- t_K – intervali, i shprehur në vite dhe fraksione të vitit (me presje dhjetore), ndërmjet tërheqjes së parë të kredisë dhe çdo tërheqje të mëtejshme deri në tërheqjen e m-të;
- $t_{K'}$ – intervali, i shprehur në vite dhe fraksione të vitit (me presje dhjetore), ndërmjet tërheqjes së parë të kredisë dhe çdo ripagese/shlyerje të mëtejshme nga e para deri në ripagesën e m'-të;
- i – norma vjetore në përqindje e detyrimit.

Neni 9

Procedura për hartimin dhe raportimin e normave të interesit mbi sasinë gjendje në fund të periudhës

1. Formularët “Normat e interesit mbi sasinë gjendje në fund të periudhës” të përcaktuar në Aneksin 1, duhet të raportojnë gjendjen e kredive, depozitave dhe transaksioneve repo në ditën e fundit të muajit të raportimit (periudha referencë).
2. Kreditë (përfshirë overdrafte-t, linjat e kredive dhe borxhi i zgjeruar i kartave të kreditit) raportohen të ndara sipas afatit të maturimit dhe detajohen sipas afatit fillestar të maturimit, afatit të mbetur të maturimit, si dhe sipas periudhës së rivendosjes së normës së interesit. Depozitat njëditore (overnight), depozitat me afat dhe depozitat me njoftim paraprak, gjithashtu, raportohen të veçuara.
3. Overdrafti, linjat e kredive dhe kredia dy-nivelëshe përmes kartave të pagesës do të raportohen në intervalin e afatit të maturimit deri në një vit. Në raportimin e normave të interesit mbi sasinë gjendje në fund të periudhës do të konsiderohet totali i balancës së kredisë lehtësuese dhe të zgjeruar të kartave të pagesës.
4. Kreditë dhe depozitat duhet të raportohen të detajuara dhe përkatësisht sipas maturitetit fillestar të raportimit dhe maturitetit të rënë dakord.
5. Në raportimin e statistikave të normave të interesit mbi sasinë gjendje në fund të periudhës, kreditë me probleme dhe kreditë e ristrukturuara jashtë kushteve të tregut nuk duhet të merren parasysh në llogaritjen e normës së ponderuar të interesit, si dhe gjendjen në fund të periudhës. Përcaktimi i kredisë me probleme dhe kredive të ristrukturuara, do t'i refererohet përcaktimeve në, neni 4, pika 2 të rregullores së Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, miratuar me vendimin nr.62, datë 14.09.2011, i ndryshuar.
6. Norma mesatare e ponderuar e interesit për formularët “Normat e interesit mbi sasinë gjendje në fund të periudhës” do të llogaritet duke zbatuar formulën e mëposhtme:

$$R = \left(\frac{A_1 \times V_1 + A_2 \times V_2 + \dots + A_n \times V_n}{\sum_{k=1}^n V} \right)$$

Ku:

R – norma mesatare e ponderuar e interesit;

V_n – gjendja (stoku) e secilës kredi, depozitë apo transaksion repo në fund të periudhës së raportimit;

A_n – norma vjetore e pranuar, ose norma efektive e interesit sipas përkufizimit të ngushtë e secilës kredi, depozitë apo transaksion repo;

Neni 10

Kërkesat për saktësinë e informacionit

1. Bankat sigurojnë saktësinë e të dhënave që raportohen sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.
2. Bankat, në rastet që identifikojnë pasaktësi në të dhënat e raportuara pas dërgimit të tyre në Bankën e Shqipërisë, njoftojnë menjëherë Departamentin e Statistikave Financiare mbi këto pasaktësi.
3. Banka e Shqipërisë, në rastet kur konstaton se të dhënat e raportuara janë të pasakta, urdhëron korrigjimin dhe ridërgimin të dhënave të korrigjuara nga bankat.
4. Bankat, në zbatim të pikës 3 të këtij neni, kryejnë korrigjimet përkatëse dhe i raportojnë ato brenda ditës pasardhëse të punës.
5. Në rastet kur në formularët e “Normave të interesit mbi sasinë e re (fluksi i ri)” vërehet një ndryshim i barabartë ose më i madh se 2 pikë përqindje në normat e interesit të raportuara, krahasuar me të njëjtin tregues në raportimin e periudhës paraardhëse, banka duhet të specifikojë normën e interesit të treguesit përkatës, arsyen e ndryshimit dhe detaje të tjera në lidhje me kontratën përkatëse.

Neni 11

Anekset

Anekset bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse e saj.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën 01.12.2017.

Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës

Gent Sejko

Aneks 1. Formularët e raportimit

NR. I FORMULARIT: FA_ALL

EMRI I FORMULARIT: Normat e interesit mbi sasinë gjendje në fund të periudhës të emëruar në lek

PERIODICITETI: Mujor

MONEDHA E RAPORTIMIT: ALL

NJESIA: Njësi monetare

Vlerë numerike

Nuk raportohet

	Sektori	Tipi i instrumentit	Maturiteti fillestar	Gjendja në fund të periudhës	Numri korespondues i kontratave	Norma e interesit (%)
Depozita në lek	për individët	me afat të caktuar	deri 2 vjet			AAR
			mbi 2 vjet			AAR
	për korporatat jofinanciare	me afat të caktuar	deri 2 vjet			AAR
			mbi 2 vjet			AAR
	Repo					AAR
Kredi në lek	për individët	për blerje banesash	deri 1 vit			AAR
			nga 1 -5 vjet			AAR
			mbi 5 vjet			AAR
		Kredi konsumatore dhe kredi të tjera	deri 1 vit			AAR
			nga 1 -5 vjet			AAR
			mbi 5 vjet			AAR
	për korporatat jofinanciare		deri 1 vit			AAR
			nga 1 -5 vjet			AAR
mbi 5 vjet					AAR	

NR. I FORMULARIT: FA_EUR

EMRI I FORMULARIT: Normat e interesit mbi sasinë gjendje në fund të periudhës të emëruar në euro

PERIODICITETI: Mujor

MONEDHA E RAPORTIM EUR

NJESIA: Njësi monetare

Vlerë numerike
 Nuk raportohet

	Sektori	Tipi i instrumentit	Maturiteti fillestar	Gjendja në fund të periudhës	Numri korespondues i kontratave	Norma e interesit (%)
Depozita në euro	për individët	me afat të caktuar	deri 2 vjet			AAR
			mbi 2 vjet			AAR
	për korporatat jofinanciare	me afat të caktuar	deri 2 vjet			AAR
			mbi 2 vjet			AAR
	Repo					AAR
Kredi në Euro	për individët	për blerje banesash	deri 1 vit			AAR
			nga 1 -5 vjet			AAR
			mbi 5 vjet			AAR
		Kredi konsumatore dhe kredi të tjera	deri 1 vit			AAR
	nga 1 -5 vjet				AAR	
		për korporatat jofinanciare	deri 1 vit			AAR
	nga 1 -5 vjet				AAR	
mbi 5 vjet				AAR		

NR. I FORMULARIT: FA_USD

EMRI I FORMULARIT: Normat e interesit mbi sasinë gjendje në fund të periudhës të emëruar në usd

PERIODICITETI: Mujor

MONEDHA E RAPORTIM USD

NJESIA: Njësi monetare

Vlerë numerike
Nuk raportohet

